

VENDIM
Nr.703, datë 23.4.2008

**PËR MIRATIMIN E STUDIMIT “ZHVILLIMI I INTEGRUAR (NË SINERGJI) I ZONËS
ENERGJETIKE DHE INDUSTRIALE TË PORTO-ROMANOS, DURRËS, INFRASTRUKTURA
DHE KONTURET E SAJ”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e studimit “Zhvillimi i integruar (në sinergji) i zonës energjetike dhe industriale të Porto-Romanos, Durrës, infrastruktura dhe konturet e saj”, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Brenda tri muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi të përgatitet, për t’u paraqitur në KRRTRSH, masterplani për këtë zonë dhe për infrastrukturën përkatëse të lidhjes së saj me rrjetin rrugor, automobilistik dhe hekurudhor, dhe me rrjetin elektroenergjetik kombëtar.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, brenda tri muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të paraqesë në Këshillin e Ministrave aktin nënligjor, për kushtet dhe procedurat e dhënies të së drejtës subjekteve juridike, për marrjen, në dispozicion, të sipërfaqeve të parashikuara për ndërtimin e objekteve dhe zhvillimin e veprimtarisë përkatëse në zonën energjetike dhe industriale të Porto-Romanos, Durrës.

4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe këshilli i qarkut të Durrësit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha